

RAPORTI VJETOR 2014

Instituti i Sigurimeve INSIG sh.a



Përmbajtja

Letra e Drejtorit të Përgjithshëm	6
Zhvillimet ekonomike në vend	8
Tregu i sigurimeve	9
Paraqitja e shoqërisë INSIG sh.a.	10
Pronësia mbi shoqërinë INSIG sh.a.	11
Këshilli mbikqyrës	11
Organizimi i shoqërisë INSIG sh.a.	11
Rrjeti i Shpërndarjes së INSIG sh.a.	11
Organigrama e INSIG sh.a.	12
Aktiviteti Sigurues	13
Dëmet nga veprimtaria siguruese	17
Pasqyrat e pozicionit financiar e konsoliduar.....	18
Pasqyra e fitim humbjeve dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse e konsoliduar	19
Pasqyra e ndryshimeve në kapital e konsoliduar.....	20
Pasqyra e konsoliduar e fluksit të parasë	21
Shënime mbi pasqyrat financiare	22

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



I nderuar zoti Ministër,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës!

Zonja dhe Zotërinj,

Programi financiar dhe objektivat e veprimtarisë së INSIG sh.a. për vitin ushtrimor 2014 kanë synuar ndalimin e rënies së vazhdueshme të pozicionit të shoqërisë në tregun e sigurimeve dhe të problematikave të tjera komplekse të trashëguara nga administrimi i mëparshëm i saj. Kjo është arritur nëpërmjet rishikimit, stabilizimit dhe konsolidimit, sipas kërkesave të ligjit dhe standardeve përkatëse, të të gjithë treguesve ekonomikë e financiarë lidhur me asetet, të ardhurat dhe shpenzimet, si edhe të profesionalizmit dhe integritetit të kapaciteteve njerëzore në praktikat e punës së shoqërisë dhe në shërbimet e ofruara ndaj klientëve.

Treguesit ekonomikë e financiarë dhe të dhënat e tjera që rezultojnë në përfundim të vitit ushtrimor 2014, dëshmojnë se, në tërësi, INSIG sh.a. ka mundur të përmbushë një pjesë të mirë të detyrave dhe objektivave të vendosura nga programi financiar dhe i veprimtarisë së shoqërisë. Është vendi për të evidentuar që për arritjen e këtyre rezultateve kanë kontribuar me punën dhe angazhimin e tyre drejtuesit dhe punonjësit e grupit INSIG në tregjet e të tre territoreve ku shoqëria jonë është e pranishme, në Maqedoni, Kosovë, dhe në mënyrë të veçantë INSIG sh.a. që operon në tregun shqiptar të sigurimeve.

Kështu, për herë të parë, jo vetëm që u ndal fenomeni i rënies dhe përkeqësimit të vazhdueshëm të pozitës në treg të INSIG sh.a. Shqipëri, por edhe u arrit që kjo shoqëri, në pjesën më të madhe të fushave të sigurimit, të përmirësojë pozicionin në treg, duke rritur ndjeshëm të ardhurat nga shitja e produkteve të saj dhe duke menaxhuar në mënyrë efikase shpenzimet.

Duke u përballur me disa problematika të trashëguara komplekse dhe të pazgjidhura, INSIG sh.a. Shqipëri ka ndërmarrë një numër masash, një pjesë e të cilave të paparashikuara në

programin financiar por të domosdoshme për evidentimin, sistemimin dhe konsolidimin e llogarive dhe asetëve të saj sipas kërkesave të ligjit dhe standardeve teknike.

Megjithatë, të dhënat financiare të shoqërisë në përfundim të vitit 2014 dëshmojnë për një numër arritjesh në stabilitetin financiar të saj, duke mbajtur nivelin e duhur të kapitalit, duke zvogëluar kostot operacionale, si edhe duke investuar mjetet e saj në tregun financiar, për të siguruar një kthim optimal.

Duke u kujdesur për respektimin e detyrimeve që burojnë nga ligji dhe marrëdhëniet kontraktore, gjatë vitit 2014 INSIG, në shumë drejtime, ka bërë përpjekje të mira dhe me impakt pozitiv, duke u ofruar klientëve më shumë besim, siguri dhe fleksibilitet, nëpërmjet produkteve sa më bashkëkohore për klientët e saj ekzistues e të rinj dhe të leverdisshme reciprokisht, si nëpërmjet rrjetit të agjentëve, ashtu edhe nëpërmjet personelit të strukturave që operojnë në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur, pasqyrohen disa të dhëna dhe tregues financiarë për vitin ushtrimor 2014.

Në fushën e Sigurimeve të Pasurisë, të ardhurat bruto nga primet (për Shqipërinë) janë në shumën 115,252 mijë Lekë. Ky tregues, është rezultat i një angazhimi të veçantë të INSIG sh.a. për të përmirësuar veprimtarinë e marrjes në sigurim në këtë fushë të sigurimeve të jo-jetës, si një nga elementët e rëndësishmëm për rritjen e portofolit dhe të fitimit të shoqërisë edhe në të ardhmen.

Fusha e Sigurimit Motorrik, sikurse për të gjitha shoqëritë e tjera që operojnë në treg, edhe për INSIG vijon të mbetet veprimtaria kryesore e cila kontribuon dhe ndikon në arritjen e objektivave të tij, si për shtimin dhe zgjerimin e klientelës, ashtu edhe për rritjen e të ardhurave të shoqërisë. Kjo fushë e veprimtarisë sonë të sigurimeve, përbën rreth 68% për qind të të ardhurave nga primet për sigurimin e jo jetës.

Në fushën e sigurimit **Jetë & Shëndet,** tregu i sigurimeve ka reflektuar problemet dhe vështirësitë e tregut financiar në tërësi. Megjithatë, duke u bazuar në njohuritë e specialistëve tanë mbi trendet e vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe jetëgjatësisë etj, INSIG sh.a., ka bërë përpjekje të vazhdueshme për t'u ofruar klientëve zgjidhje të përshtatshme për të siguruar rrezikun e tyre dhe nevojat e menaxhimit të kapitaleve. Në këtë fushë të sigurimeve të ardhurat bruto të INSIG sh.a., Shqipëri për vitin 2014 janë në shumën 132,129 mijë Lekë.

Gjatë vitit ushtrimor 2014 INSIG sh.a., i ka kushtuar vëmendje të posaçme përmirësimit të profesionalizimit dhe të treguesve që lidhen me ekspertizën, korrektësinë dhe shpejtësinë e trajtimit të rasteve, si edhe pagesën e dëmeve që u janë shkaktuar klientëve dhe personave që i përfitojnë ato sipas kontratës dhe ligjit, duke zbatuar standarde profesionale në trajtimin e tyre, si në dëmet e linjës Jo-Jetë, ashtu dhe në ato të Jetës.

Të dhënat dhe treguesit ekonomikë e financiarë të vitit ushtrimor 2014 shërbejnë si një bazë e mirë lidhur me pritshmëritë nga objektivat e programit financiar të vitit ushtrimor 2015, për garantimin e një shërbimi sa më cilësor dhe tërheqës për klientët, si edhe për të përballuar me profesionalizëm sfidat e shumta me të cilat ballafaqohet tregu i sigurimeve, përfshirë edhe ato që lidhen me arritjen e treguesve financiarë dhe të performancës më të mirë të mundshme në kuadër të procesit të privatizimit të shoqërisë.

EDLIRA DVORANI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

I. ZHVILLIMET EKONOMIKE NË VEND

Ekonomia shqiptare shënoi një aktivitet të përmirësuar ekonomik në vitin 2014. Sipas të dhënave të INSTAT-it, vlera e shtuar bruto u rrit me 1.4% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit dhe treguesit e tërthortë sugjerojnë se ajo është përshpejtuar më tej në tremujorin e katërt. Treguesit e stabilitetit të përgjithshëm ekonomik e financiar të vendit shënuan përgjithësisht përmirësime, ndonëse ekonomia shqiptare vazhdon të operojë me kapacitet jo të plotë dhe të përballet me një ambient të jashtëm të pafavorshëm.

Në aspektin makroekonomik, inflacioni dhe pritjet inflacioniste vazhduan të qëndrojnë në nivele të ulëta. Në sferën e financave publike, viti 2014 u karakterizua nga një politikë fiskale konsoliduese. Të ardhurat fiskale u rritën dhe, duke përjashtuar pagimin e detyrimeve të prapambetura, defiçiti buxhetor u reduktua. Në sferën e marrëdhënieve ekonomike e financiare me jashtë, viti 2014 nuk shënoi ndryshim të trajektoreve të mëparshme. Defiçiti i llogarisë korrente u rrit, por bilanci i pagesave rezultoi pozitiv dhe kursi i këmbimit u shfaq i qëndrueshëm.

Në aspektin financiar, ekonomia shqiptare dhe sistemi i saj financiar njohën progres gjatë vitit 2014, në drejtim të përmirësimit të treguesve të likuiditetit, të përfitueshmërisë dhe të cilësisë së aktiveve. Megjithatë, aktiviteti ndërmjetësues i sektorit bankar mbetet i ulët dhe bilancet e tij vazhdojnë të vuajnë nga kreditë me probleme.

Vlerësimet e Bankës së Shqipërisë sugjerojnë se rritja ekonomike e vitit 2014 do të jetë më e lartë se ajo e vitit paraardhës. Kjo rritje është mbështetur në masën më të madhe nga rritja e konsumit dhe e investimeve private, si pasojë e përmirësimit të besimit të biznesit e të konsumatorit, përmirësimit të balanceve në sektorin privat dhe kushteve më të mira të financimit. Politika konsoliduese fiskale rezultoi në reduktimin e stimulit fiskal dhe kërkesa e huaj nuk ndihmoi rritjen ekonomike. Problemet ekonomike të partnerëve tanë tregtarë nuk favorizuan rritjen e kërkesës për mallra e shërbime shqiptare në prani edhe të disa goditjeve të ofertës ato u reflektuan në një rritje të ulët të eksporteve tona. Ndonëse në rritje, kërkesa agregate ishte e pamjaftueshme për të vënë në shfrytëzim të plotë kapacitetet prodhuese të ekonomisë.

Dobësia ciklike e kërkesës ka krijuar një mjedis ekonomik me presione të dobëta për rritjen e pagave, të kostove të punës, të marzheve të fitimit dhe të inflacionit të çmimeve të konsumit. Gjithashtu, inflacioni i importuar erdhi në rënie dhe shtoi presionet disinflacioniste në ekonomi. Për rrjedhojë, inflacioni i çmimeve të konsumit regjistroi një vlerë mesatare prej 1.6% gjatë vitit 2014, duke mbetur nën objektivin e Bankës së Shqipërisë.


Përtej nxitjes së kërkesës së brendshme, tejçimi i stimujve monetarë në ekonomi pati rrjedhoja pozitive edhe në treguesit e shëndetit financiar. Frenimi i rritjes së kredive me probleme, përmirësimi i likuiditetit në sistem, ruajtja e balanceve të shëndosha të sektorit financiar të ekonomisë si dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit, kanë ndihmuar stabilitetin financiar të vendit.

II . TREGU I SIGURIMEVE

Gjatë vitit 2014 tregu shqiptar i sigurimeve pati një rritje të ndjeshme nga pikëpamja e vëllimit total të primeve të shkruara bruto të cilat kapën shifrën 11.62 miliardë lekë, duke u rritur me afro 36.15% krahasuar me vitin 2013 dhe me një rritje mesatare në pesë vitet e fundit prej 8.95%. Nga pikëpamja e numrit të shoqërive vepruese në këtë treg, gjatë vitit 2014, pati një zvogëlim të tyre që erdhi nga bashkimi me përthithje i dy shoqërive të sigurimeve, në një të vetme.

Në strukturë, tregu vazhdoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën rreth 90.93% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, sollën 8.83% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë 2014, sigurimet vullnetare zunë 40.48% dhe ato të detyrueshme zunë 59.52% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.

Gjatë vitit 2014, rritja e tregut të sigurimeve është e ndikuar kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimeve të detyrueshme motorike.



III. PARAQITJA E SHOQËRISË INSIG sh.a.

Gjatë vitit 2014, INSIG sh.a. vijoi kryerjen e veprimtarisë së saj të shtrirë në tre territore, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Më 31 Dhjetor 2014, INSIG sh.a. kishte 230 punonjës të punësuar në këto tre vende.

Sigurimet e jo-jetës në të tre vendet u përfaqësuan nga produkte të ndryshme, që mbulojnë përgjegjësinë e mbajtësve të mjeteve motorike kundrejt palëve të treta, kasko, zjarrin dhe rreziqet shtesë, vjedhjen, sigurimet e bankave, tipe të ndryshme të përgjegjësisë, marinën dhe mallrat në transport, bujqësinë dhe blegtorinë, etj.

Sigurimet e jetës të ofruara nga Kompania konsistojnë kryesisht në produkte afatshkurtra, si sigurimi i jetës individuale dhe në grup, sigurimi i jetës së nxënësit dhe studentit, sigurimi i jetës së debitorit, sigurimi i kombinuar i jetës, sigurimi i Jetë dhe Shëndet.

Gjatë vitit 2014, INSIG sh.a., ruajti marrëdhënie të qëndrueshme të biznesit me lojtarë të rëndësishëm të tregjeve ndërkombëtare të sigurimeve dhe risigurimeve. INSIG sh.a., cedoi një pjesë të rreziqeve tek risiguruesit ndërkombëtare, duke u bazuar në ligjet përkatëse në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në deklaratën e politikës së veprimtarisë.

Në 23 vjet veprimtari, INSIG-u ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetet e burimeve njerëzore, nëpërmjet politikave të pranimi dhe programeve të vazhdueshme të trajnimit.

IV. PRONËSIA MBI SHOQËRINË

Në përputhje me Statutin e shoqërisë, Neni 6, kapitali themeltar është 1,020,000,000 lekë (një miliard e njëzetë milionë), i ndarë në 1,700 (njëmijë e shtatëqind) aksione, me vlerë nominale 600,000 (gjashtëqindmijë) lekë secili. Gjatë vitit 2014, aksionet e shoqërisë u zotëruan në masën 100 % nga Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministri i Financave.

KËSHILLI MBIKQYRËS :

Ervin Mete – Kryetar

Engjëll Agaci – Zëvendës Kryetar

Anila Denaj – Anëtar

Luneda Sufali - Anëtar

Spiro Brumbulli – Anëtar

ORGANIZIMI I SHOQËRISË :

Numri mesatar i punonjësve të kompanisë gjatë vitit:

Zyrat qendrore Tiranë : 55

Degët në Shqipëri : 57

Dega INSIG Kosovë : 38

Maqedoni : 80

RRJETI I SHPËRNDARJES SË SHOQËRISË INSIG sh.a.

Degët dhe numri i punonjësve

Shqipëri

Gjendja 31.12.2014	
Degët / Agjencitë	Nr. i punonjësve
Berat	2
Dibër	2
Durrës	4
Elbasan	5
Fier	4
Gjirokastrë	3
Kavajë	3
Korçë	3
Kukës	2
Laç	1
Lezhë	1
Lushnje	3
Pogradec	3
Sarandë	3
Shkodër	3
Tiranë	12
Vlorë	3
Total Degë / Agjenci	57


Kosovë

Gjendja 31.12.2014	
Filiali	Nr. i punonjësve
Qendër	29
Prishtinë - Mitrovicë	3
Ferizaj - Gjilan	2
Prizren	2
Pejë - Gjakovë	2
Totali	38

Maqedoni

Gjendja 31.12.2014	
Filiali	Nr. i punonjësve
Qendër	28
Shkup	8
Kumanovë	4
Tetovë	9
Gostivar	4
Kavadarci	3
Strumica	3
Bitola	3
Kocani	2
Veles	3
Prilep	1
Struga	2
Kicevo	2
Resen	1
Negotino	1
Gjevgjelia	1
Shtipi	2
Dibër	2
Ohër	1
Totali	80

V. ORGANIGRAMA



VI. TREGUESIT FINANCIARË


AKTIVITETI SIGURUES

Në vitin 2014 u shkruan 1.799.303.465 lekë prime nga sigurimet e jo-jetës dhe sigurimet e jetës. Shpërndarja territoriale e primeve për vitin 2014 ishte: Shqipëri 43%, Kosovë 33 % dhe Maqedoni 24 %. Rreth 80 % e primeve të shkruara bruto erdhi nga sigurimet motorrike, 11 % nga sigurimet e pronës, 7 % nga sigurimi i jetes, dhe 2 % nga sigurimet e jetës dhe të shëndetit.

SHPËRNDARJA E PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO SIPAS TERRITOREVE :

Prime të shkruara bruto	Ndaj totalit viti 2014	Ndaj totalit viti 2013
Shqipëri	43%	31%
Kosovë	33%	46%
Maqedoni	24%	23%
Total	100%	100%


Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas territoreve



SHPËRNDARJA E PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO SIPAS LINJAVE TË BIZNESIT PËR GRUPIN INSIG:

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2014	Ndaj totalit viti 2013
Mjete motorrike	80%	75%
Pasuri	11%	14%
Jetë	7%	9%
Shëndet	2%	2%
Totali	100%	100%

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit




SHQIPËRIA

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2014	Ndaj totalit viti 2013
Mjete motorrike	68%	49 %
Pasuri	15%	21 %
Jetë	16%	29 %
Shëndet	1%	1 %
Totali	100%	100%

Primet e shkruara bruto në vitin 2014 ishin 778.132.184 lekë. Rreth 68 % e primeve erdhën nga sigurimet motorrike 15 % nga sigurimet e pronës dhe 17 % nga sigurimet e jetës dhe shëndetit.

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit në Shqipëri




KOSOVA

Primet e shkruara bruto në vitin 2014 ishin 586.239.100 lekë. Rreth 88 % e primeve erdhën nga sigurimet motorrike 12 % nga sigurimet e pronës dhe 0,2 % nga sigurimet e shëndetit.

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2014	Ndaj totalit viti 2013
Motorrike	88 %	84 %
Pasuria	12 %	15 %
Jeta	-	0 %
Shëndeti	0,2%	1 %
Totali	100 %	100 %

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit




MAQEDONIA

Primet e shkruara bruto në vitin 2014 ishin 434.932.181 lekë. Rreth 92 % e primeve erdhën nga sigurimet motorrike 3 % nga sigurimet e pronë dhe 5 % nga sigurimet e jetës dhe shëndetit.

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2014	Ndaj totalit viti 2013
Motorrike	92 %	93 %
Pasuria	3 %	2 %
Jeta	-	0
Shëndeti	5%	5 %
Totali	100%	100%

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit në Kosovë



DËME TË PAGUARA

Përgjatë vitit 2014 INSIG sh.a. u fokusua në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj klientit nëpërmjet procedurave më fleksibile dhe të shpejtë. Gjatë vitit 2014 vlera e dëmeve të paguara kapin shifrën prej 604.441.496 lekë.

Dëme të paguara në lekë (Grupi)	
2014	604.441.496
2013	800.607.335

Insig Sh.a.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR E KONSOLIDUAR

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013 riparaqitur	1 Janar 2013
AKTIVET				
Mjete monetare dhe ekuivalente	8	297,739,914	692,734,970	1,319,584,224
Depozita me afat me bankat	9	2,521,687,262	2,381,926,934	1,523,901,470
Investime të mbajtura në maturim	10	1,427,649,299	1,005,126,376	1,518,364,108
Investime të mbajtura për tregtim	11	58,437,014	45,595,931	-
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi e të tjera	12	166,669,168	115,620,151	228,443,097
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim	13	109,511,557	164,472,730	176,252,514
Aktive të risigurimit	14	258,026,983	338,450,317	207,381,361
Të arkëtueshme nga risiguresi	15	7,983,834	47,554,019	13,638,982
Tatim fitimi i parapaguar		41,965,088	30,032,243	-
Ndertesat dhe pajisje	16	152,103,512	174,999,097	128,944,270
Aktive jo-materiale	17	11,390,766	13,604,405	6,532,812
Aktive të tjera	18	121,764,638	141,384,726	90,484,045
TOTALI AKTIVEVE		5,174,929,035	5,151,501,899	5,213,526,883
DETYRIMET				
Rezerva për demet dhe shpenzimet për trajtimin e demeve	19	2,033,905,703	1,868,977,036	1,799,698,493
Rezerva për primet e paftuara	20	690,386,347	722,889,797	863,454,959
Të pagueshme për risigurim	21	63,227,036	40,089,125	19,550,865
Detyrimet mbi tatimit mbi fitim		8,872,514	11,751,704	-
Detyrime të tjera	22	128,065,715	131,684,363	151,894,567
Provizione të tjera	23	18,433,860	24,793,857	15,534,464
Tatim i shtyrë	37	7,236,625	56,481,625	48,956,823
Totali i Detyrimeve		2,950,127,800	2,856,667,507	2,899,090,171
Kapitali				
Kapitali themeltar	24	1,020,000,000	1,020,000,000	1,020,000,000
Rezerva e rivlerësimit	25	180,626,537	180,626,537	139,618,997
Rezerva për parandalim dëmi	26	44,677,559	44,677,559	44,677,559
Rezerva për katastrofë	27	-	439,201,903	439,199,661
Rezerva të tjera	28	1,164,171,785	662,672,035	649,590,911
Rezerva e përkthimit		123,456,413	122,883,858	119,215,110
Humbje të mbartura		(308,131,059)	(175,227,500)	(97,865,526)
Totali i kapitalit aksionar		2,224,801,235	2,294,834,392	2,314,436,712
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar		5,174,929,035	5,151,501,899	5,213,526,883

Shënimet në faqet 5 deri 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Këto pasqyra të financiare konsoliduara janë aprovuar nga drejtimi i Grupit më 30 Qershor 2015:

Edlira Dvorani
Drejtor i përgjithshëm



Paqesor Pepi
Drejtor i financës

Insig Sh.a.

PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE E KONSOLIDUAR

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shenime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 riparaqitur
Prime të shkruara bruto	29	1,799,303,465	1,792,392,784
Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara	20	32,367,118	142,496,169
Prime të shkruara neto		1.831.670.583	1.934.888.953
Prime të ceduara risiguruesve	30	(171,330,591)	(261,763,000)
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara për pjesën e risiguruesit		(24,147,148)	(17,158,861)
Prime të shkruara neto		1.636.192.844	1.655.967.092
Të ardhura të tjera nga marrja në sigurim	31	21,598,790	14,164,602
Shpenzimet e demeve dhe te trajtimit te demeve	19	(825,732,698)	(728,708,398)
Shpenzimet e marrjes ne sigurim	32	(230,806,339)	(304,454,936)
Shpenzime administrative	33	(830,149,808)	(822,026,654)
Humbje operative		(228.897.211)	(185.058.294)
Të ardhurat financiare	35	103,142,332	195,072,370
Të ardhura/(humbje) nga kurset e këmbimit, neto	36	36,448,979	(6,289,371)
Të ardhura financiare neto		139,591,311	188,782,999
(Humbja)/fitimi para tatimit		(89,305,900)	3,724,705
Tatimi mbi fitimin	37	(30,544,812)	(41,959,396)
Humbja e vitit		(119,850,712)	(38,234,691)
Të ardhura përmbledhëse të tjera		49,817,554	44,678,530
Rezerva përktimi		572,554	3,668,748
Rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		-	48,244,165
Tatim i shtyre nga rivlersimi i aktiveve të qëndrueshme		-	(7,236,625)
Tatimi i shtyrë nga rezerva e katastrofës		49,245,000	2,242
Totali i humbjes/te ardhurave permbledhese te vitit		(70.033.158)	6.443.839

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Insig Sh.a.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL E KONSOLIDUAR
(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali Aksioner	Rezerva e rivelësimit	Rezerva për dëmet	Rezerva për ka- tastrofë	Rezerva të tjera	Rezerva e perkthimit	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 Janar 2013	1,020,000,000	139,618,997	44,677,559	439,199,661	649,590,911	119,215,110	(97,865,526)	2,314,436,712
Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	(38,234,691)	(38,234,691)
Të ardhura përmbledhëse të tjera								
Ndryshime nga kursi i këmbimit	-	-	-	-	-	3,959,167	-	3,959,167
Totali i të ardhura përmbledhëse të tjera	-	-	-	-	-	3,959,167	-	3,959,167
Totali i fitim/(humbjeve) përmbledhëse	-	-	-	-	-	3,959,167	(38,234,691)	(34,275,524)
Korrigjim i gabimit (referoju shenimit 2.e)	-	41,007,540	-	2,242	-	(219,419)	-	40,719,363
Totali i fitim/(humbjeve) përmbledhëse (riparaqitur)	-	41,007,540	-	2,242	-	3,668,748	(38,234,691)	6,443,839
Rritja e rezervave të tjera	-	-	-	-	13,081,124	-	(13,081,124)	-
Dividentë te paguar	-	-	-	-	-	-	(26,046,159)	(26,046,159)
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital								
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	-	-	-	13,081,124	-	(39,127,283)	(26,046,159)
Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	(119,850,712)	(119,850,712)
Të ardhura përmbledhëse të tjera								
Riklasifikim i rezervës së katastrofës	-	-	-	49,245,000	-	-	-	49,245,000
Ndryshime nga kursi i këmbimit	-	-	-	-	-	572,555	-	572,555
Totali i të ardhura përmbledhëse të tjera	-	-	-	49,245,000	-	572,555	-	49,817,555
Totali i fitim/(humbjeve) përmbledhëse	-	-	-	49,245,000	-	572,555	(119,850,712)	(70,033,157)
Rritja e rezervave të tjera	-	-	-	-	13,052,847	-	(13,052,847)	-
Riklasifikim i rezervës së katastrofës	-	-	-	(488,446,903)	488,446,903	-	-	-
Dividentë te paguar	-	-	-	-	-	-	-	-
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital								
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	-	-	-	(439,201,903)	501,499,750	-	(13,052,847)	-
Humbja e vitit	-	-	-	-	1,164,171,785	123,456,413	(308,131,059)	2,224,801,235

Insig Sh.a.**PASQYRA E KONSOLIDUAR FLUKSIT TË PARASË***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*Për vitin e mbyllur 31 Dhjetor
2014 2013**Fluksi i parasë nga aktivitetet operative**

Humbja pas tatimit	(119,850,712)	(38,234,691)
Rregullime për:		
Zhvlerësimin	20,125,729	18,798,491
Nxjerrja jashtë përdorimit	12,176,854	7,668
Shpenzimet e zhvlerësimit	20,311,251	22,988,331
Ndryshime në detyrimet prej humbjeve dhe shpenzimet nga rregullimet e humbjeve	164,928,667	69,278,542
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	(32,503,450)	(140,565,162)
Ndryshimi në aktivet e risigurimit	80,423,334	(131,068,956)
Të ardhura nga interesi	(103,142,333)	(166,591,303)
Ndryshime nga kursi i këmbimit	(29,032)	3,670,990

Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative para ndryshimit në aktivet dhe detyrimet operative**42,440,308 (361,716,090)***Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative*

Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme	(71,360,268)	89,834,615
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	54,961,173	11,779,784
Ndryshimi në aktive të risiguruara	39,570,185	(33,915,037)
Ndryshimi në detyrime të risiguruara	23,137,911	20,538,260
Ndryshimi në aktive të tjera	19,620,088	(50,900,681)
Ndryshimi në detyrime të tjera	(3,618,648)	(20,210,204)
Ndryshimi në provigjione të tjera	(6,359,997)	9,259,393
Tatimi mbi fitimin i paguar	(14,812,033)	(17,992,363)

Flukset monetare të gjeneruara/(te përdorura) nga aktivitetet operative**83,578,719 (353,322,323)****Flukset monetare nga aktivitetet investuese**

Blerje paisjesh dhe aktivesh jo materiale	(6,591,772)	(22,529,543)
Ndryshim në depozitat me afat	(139,760,328)	(858,025,464)
Blerje e bonove të thesarit	(422,522,923)	422,045,870
Blerje e Investime të mbajtura për tregtim	(12,841,084)	45,595,931
Interesa të marra	103,142,332	165,432,433

Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet investuese**(478,573,775) (247,480,773)****Flukset monetare nga aktivitetet financuese**

Dividend i paguar	-	(26,046,159)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese	-	(26,046,159)

Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to**(394,995,056) (626,849,254)****Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit****692,734,970 1,319,584,224****Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit (Shënimi 8)****297,739,914 692,734,970**

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Më poshtë përfshihet një informacion përmbledhës nga pasqyrat financiare të audituara

Baza e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuar nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK)

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, me përjashtim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe investimeve të mbajtura për tregtim të cilat janë paraqitur me vlerën e drejtë.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë të prezantuara në Lekë, monedha Shqiptare, që është dhe monedha funksionale e Grupit.

Korrigjimi i vitit parardhës

Gjatë 2014, Grupi vendosi të rivlerësojë një pjesë të aktiveve të qëndrueshme bazuar në raportet e vlerësimit që datojnë në Shtator 2013. Ndikimi i rivlerësimit është pasqyruar në pasqyrat financiare si një korrigjim i një gabimi material të periudhës së mëparshme duke riparuar balancat hapëse të aktiveve të qëndrueshme, të ardhurave të tjera përmbledhëse, rezervës së rivlerësimit dhe detyrimit tatimor të shtyrë, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013.

Përveç kësaj, Grupi korrigjoi disa gabime jomateriale të periudhës së mëparshme të identifikuar gjatë 2014, duke riparuar balancat hapëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013.

Baza e Konsolidimit

Filialet

Filialet janë ato entitete të cilat janë të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Grupi ka fuqinë, në mënyrë direkte dhe indirekte, të qeverisë politikat financiare dhe operative të një entiteti si dhe të sigurojë përfitim nga aktiviteti i tyre. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të ushtrimit të kontrollit deri në datën kur ky kontroll mbaron.

Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit

Balancat dhe transaksionet brënda grupit, dhe çdo e ardhur apo shpenzim i përealizuar (përveç fitimeve dhe humbjeve të transaksioneve në monedhë të huaj) që buron nga transaksione brenda grupit, janë eliminuar në momentin që janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara. Humbjet dhe fitimet e përealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë, por vetëm me kusht që të mos ketë evidencë për masën e zhvlerësimit.

Menaxhimi i Rrezikut Financiar

Grupi monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Grupi nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjedhojë e ndryshimeve të tregut të tilla si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politika dhe procedura për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përkeqëson të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet.

Risku i kredisë

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit. Grupi ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB ose më të larta dhe të plotësojnë kërkesat e Grupit përsa i përket Rregullave të Sigurisë për Risigurimet. Grupi menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpartitë e depozitave me afat

Analiza e ndjeshmërisë

Tabela e mëposhtme detajon ndjeshmërinë e Grupit ndaj rritjes dhe uljes së Lekut përkundrejt monedhave të tjera relevante. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret kur bëhen raportimet e brendshme të riskut nga kurset e këmbimit për personelin e lartë menaxherial dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Në çdo analizë të ndjeshmërisë paraqitet ndikimi i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë supozohen të pandryshuar, në analizën e ndjeshmërisë. Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 (në '000 Lekë):

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014:

Shuma	Ndikimi	
EUR rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	209,466
EUR bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(209,466)
USD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	34,703
USD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(34,703)
MKD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	75,675
MKD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(75,675)

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013:

Shuma	Ndikimi	
EUR rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	219,389
EUR bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(219,389)
USD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	23,925
USD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(23,925)
MKD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	61,553
MKD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(61,553)

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti. Më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 Grupi nuk ka pasur detyrime të rëndësishme interesmbajtëse dhe asnjë instrument të rëndësishëm me normë interesi të luhatshme por ka përqendrim të rëndësishëm të riskut të normave të interesit në depozita me afat dhe bonot e thesarit me maturitet ndërmjet 3 muaj dhe 1 vit.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rreziku që Grupi nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Grupit sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Grupi do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Grupi ka akses në huamarrje më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013. Grupi administron riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Supozime dhe sensitiviteti

Reziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën sasiore të ndjeshmërisë. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Grupi e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një pamje e përgjithshme e humbjeve nga dëmet dhe raportit të kombinuar për vitin 2014 dhe 2013 jepet më poshtë:

	2014	2013
Raporti i dëmeve	51%	41%
Raporti i shpenzimeve	65%	63%
Raporti i kombinuar	115%	104%

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj ndjeshmërie tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara (në '000 Lekë):

	Impakti	2014	2013
Raporti i dëmeve			
5% rritje në raportin e dëmeve	Humbje	(41,326)	(36,427)
5% rënie në raportin e dëmeve	Fitim	(41,326)	(36,427)

Raporti i shpenzimeve			
5% rritje në raportin e shpenzimeve	Humbje	(52,935)	(56,331)
5% rënie në raportin e shpenzimeve	Fitim	(52,935)	(56,331)

Raporti i kombinuar			
5% rritje në raportin e kombinuar	Humbje	(94,261)	(92,757)
5% rënie në raportin e kombinuar	Fitim	(94,261)	(92,757)

